

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MBËSHTETJEN DHE ZHVILLIMIN E STARTUP-EVE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji ka për qëllim krijimin i një kuadri rregullator dhe institucional, i cili mbështet e favorizon krijimin dhe zhvillimin e *startup*-eve dhe mbështetjen e ekosistemit për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë.

Ky projekt ligj synon të plotësojë boshllëkun ligjor ekzistues, pasi në Republikën e Shqipërisë, deri më sot, nuk ka pasur dispozita, të cilat rregullonin situatat e lidhura me *startup*-et.

Objektivat që synohen të arrihen përmes miratimit të këtij projektligji dhe zbatimit të tij janë:

- përcaktimi i lehtësirave fiskale, i programeve dhe masave që mbështesin *startup*-et në fazën fillestare të biznesit (periudha e inkubimit) dhe mbështetjen e ekosistemit për të krijuar një klimë të favorshme për to në Republikën e Shqipërisë;
- organet shtetërore, të cilat ngarkohen me detyrat e kompetencat për mbështetjen e *startup*-eve;
- përcaktimi i kritereve, rregullave dhe procedurat që zbatohen për certifikimin, mbështetjen, vlerësimin e monitorimin e *startup*-eve.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është në përputhje me programin politik të Këshillit të Ministrave, pasi ndikon drejtpërdrejt në krijimin e bizneseve të reja dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në mënyrë të veçantë, projektligji zbaton gjetjet e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020, e cila përcakton se ende mungojnë politikat mbështetëse për bizneset *startup* dhe mungojnë burimet financiare alternative, si:

venture capital, innovation vouchers, business angels etj.(ref 3.1.6. Sfidat për zhvillimin e SME-ve). Projektligji zbaton disa nga qëllimet specifike të strategjisë (Ref 2.iii - Zhvillimi i biznesit inovativ dhe 2.iv -Zhvillimi i SME-ve dhe sipërmarrjes), sipas të cilave synohet rritja e aplikimit të teknologjive të reja, rritja çdo vit e numrit të ndërmarrjeve të reja dhe të atyre inovative dhe futjen e instrumenteve të reja financiare, në veçanti në mbështetjen e atyre bizneseve që janë në fazën fillestare të tyre (*startup*).

Gjithashtu projektligji zbaton e mbulon dhe një pjesë të mbështetur në objektivat e prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022, e cila përcakton si objektivi të sajin nxitjen e biznesit për krijimin e sipërmarrjeve të reja (*startup*) në inovacion dhe teknologji (Qëllimi 1: Rritja e bashkëpunimit mes komunitetit të kërkueseve shkencorë dhe atij të biznesit, objektivi 3).

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji nuk është parashikuar në planin e përgjithshëm analitik të hartimit të akteve ligjore/nënligjore për vitin 2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji është hartuar si rezultat i nevojës për të krijuar një kuadër ligjor, që favorizon krijimin e zhvillimin e *startup*-eve dhe mbështetjen e ekosistemit të *startup*-eve në Shqipëri. Vitet e fundit është pranuar se risia në idetë e *startup*-eve konsiderohen si faktorët kryesorë të rritjes ekonomike dhe të punësimit dhe është konstatuar se kompanitë e reja të zhvilluara fillimisht si *startup*-e, renditen tashmë në vendet e para të bizneseve më të mëdha të globit. Idetë dhe risitë e zbatuara nga *startup*-et kanë revolucionuar modelet e biznesit, duke sjellë produkte dhe shërbime të reja në treg. *Startup*-et lidhen ngushtësisht me risitë dhe zhvillimin ekonomik që ato sjellin, prandaj, ekzistonte nevoja edhe në Shqipëri për të zhvilluar instrumente ligjore për t'i stimuluar ato.

Objektivat që synohen të arrihen janë zbatimi i mekanizmave mbështetës për krijimin e zhvillimin e *startup*-eve të reja, duke nxitur krijimin e një mjedisi të favorshëm dhe duke synuar thithjen e aktorëve që mungojnë aktualisht, kryesisht të subjekteve që ofrojnë inkubim, mentorim e financim të *startup*-eve të reja.

Projektligji krijon kuadrin institucional të nevojshëm, duke përcaktuar organet përkatëse shtetërore dhe kompetencat e tyre, në veçanti duke krijuar Këshillin e *Startup*-eve.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me nenin 81 të Kushtetutës dhe implementon qëllimet e strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve 2014-2020, si dhe qëllimet e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017 – 2022.

Projektligji gjithashtu synon t’u japë zbatim rekomandimeve të raportit të progresit të Komisionit të Bashkimit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2019, i cili, për sa u përket *startup*-eve, përcakton se ekziston nevoja për të krijuar instrumente ligjore për t’i stimuluar *startup*-et në drejtim të zhvillimit të tyre. Komisioni i Bashkimit Evropian sugjeron zbatimin në praktikë të qëllimeve të Strategjisë Kombëtare të Inovacionit dhe Teknologjisë dhe përparësive të vendit sipas strategjisë së zhvillimit të biznesit dhe investimeve.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk transponon specifikisht *acquis* të Bashkimit Evropian, por zbaton parimet e *EU Small Business Act*, *EU Startup Nations Standard* dhe mekanizma analogë mbështetjeje të aplikuara nga Bashkimi Evropian dhe shtetet anëtare të saj.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është konceptuar në tre krerë, duke parashikuar rregullime specifike për secilin kapitull dhe konkretisht:

Neni 1 parashikon se qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri rregullator dhe institucional të favorshëm për krijimin e zhvillimin e *startup*-eve dhe mbështetjen e ekosistemit, për nxitjen e kërkimit, realizimit dhe përdorimit të ideve, modeleve, produkteve dhe proceseve të reja, të cilat sjellin risi në çdo fushë.

Neni 2 rregullon objektin e ligjit, duke parashikuar se ligji në fjalë përcakton organet e procedurat që zbatohen për mbështetjen dhe zhvillimin e *startup*-eve dhe të ekosistemit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 3 përmban përkufizime që kanë kuptim të specializuar për qëllimet e ligjit, përfshirë shtjellimin e detajuar të termave “*startup*”, “ekosistem” apo “lehtësues

të *startup-eve*”. Me rëndësi është përkufizimi i termit “nomadë digjitalë”, që përfshin shtetasit e huaj, që punojnë nëpërmjet teknologjisë së informacionit në vende të ndryshme, jo në një zyrë apo seli të institucionit, dhe puna e tyre është kryesisht puna lëvizëse, të cilët përfitojnë statusin dhe përfitimet e “punonjësit lëvizës digjital”, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për të huajt.

Neni 4 përcakton parimet e mbështetjes së *startup-eve*, si:

- krijimi i shpejtë i *startup-eve* dhe lehtësimi i hyrjes së tyre në treg;
- tërheqja dhe mbajtja e talentit dhe e burimeve njerëzore;
- inovacioni në kuadrin rregullator dhe në procedurat e prokurimit;
- lehtësimi dhe mbështetja në aksesimin e burimeve financiare;
- përfshirja sociale dhe diversiteti në mbrojtje të vlerave demokratike.

Neni 5 parashikon format e mbështetjes së *startup-eve*, ku mbështetja për zhvillimin e *startup-eve* kryhet nëpërmjet:

- shërbimit “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e *startup-eve*;
- zhvillimit të ekosistemit mbështetës për *startup-et*;
- dhënies së granteve financiare ose masave mbështetëse për zhvillimin e *startup-eve*;
- formave të tjera mbështetëse të zhvilluara në bashkëpunim me palë të treta.

Neni 6 përmbledh organet përgjegjëse në fushën e nxitjes, ndihmës dhe zhvillimit të *startup-eve*, sipas ligjit, që janë ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, Këshilli i *Startup-eve* dhe ministrinë ose institucionet e tjera publike.

Neni 7 përcakton detyrat e ministrit përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, përfshirë kryerjen e planifikimit buxhetor, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor; menaxhon e miraton fondet buxhetore për grantet dhe format e tjera të mbështetjes së *startup-eve*, miratimin e thirrjeve për grante financiare ose masa mbështetëse, përfshirë formën dhe sasinë e granteve financiare ose formën e masave mbështetëse që do të akordohen për mbështetjen e *startup-eve*, administrimin e regjistrimit të *startup-eve* dhe lehtësuesve dhe të faqes zyrtare në internet të institucionit e portalit “*Startup Albania*”, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut, ofrimin shërbimit “*startup one-stop-shop*” për mbështetjen e *startup-eve*, dhe bashkëpunimin me institucionet vendase dhe organizata ndërkombëtare dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në rritjen së ndërgjegjësimit publik për fushën dhe veprimtarinë e *startup-eve*, si dhe në përmbushjen e detyrimeve që lindin nga ligji.

Neni 8 rregullon ngritjen e funksionimin e Këshillit të *Startup*-eve, i cili ngrihet pranë ministrisë përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes dhe jep kontribut në nxitjen e zhvillimit të *startup*-eve si organ kolegjal. Kryetar i Këshillit është ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes dhe rregulla të hollësishme mbi përbërjen dhe procedurat e Këshillit autorizohen të përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes.

Neni 9 parashikon se ministritë ose institucionet e tjera publike, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore të tyre, ndër të tjera, asistojnë procesin e mbështetjes dhe të zhvillimit të *startup*-eve, në përputhje me parimet “*paperless*” (pa letër) dhe “tarifa zero” në marrjen e shërbimeve, dhe japin mendim të arsyetuar për përputhjen ligjore midis idesë së biznesit të *startup*-it aplikues për grante ose masa mbështetëse dhe fushën e tyre të aktivitetit.

Neni 10 përcakton se personi fizik ose juridik, vendas ose i huaj, përfshirë nomadin digjital, merr statusin si “*startup*” në momentin e plotësimit të një vetëdeklarimi në regjistrin elektronik të *startup*-eve e lehtësuesve dhe kohëzgjatja e periudhës së inkubimit dhe e statusit si “*startup*” është 24 muaj nga momenti i plotësimit të vetëdeklarimit në regjistrin e *startup*-eve.

Regjistrimi dhe marrëdhënia e *startup*-eve dhe e lehtësuesve me ekosistemin dhe skemën e mbështetjes së *startup*-eve dhe lehtësuesve kryhet duke u bazuar në parimet “*paperless*” (pa letër) dhe “tarifa zero” në marrjen e shërbimeve.

Neni 11 krijon regjistrin e *startup*-eve dhe lehtësuesve si bazë shtetërore të dhënash në funksion të ligjit e të legjislacionit në fuqi për bazat e të dhënave shtetërore. *Startup*-et, në momentin e vetëdeklarimit në regjistër, dhe lehtësuesit e *startupeve*, në momentin e regjistrimit në regjistër, pajisen sipas rastit me dokumentin elektronik “pasaporta e *startup*-eve” ose “pasaporta e lehtësuesve”.

Neni 12 parashikon se ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, me qëllim mbështetjen e zhvillimit dhe të rritjes të *startup*-eve, ofron shërbimin “*startup one-stop-shop*”, si dhe rregullon format e këtij shërbimi, si:

- dhënia e informacioneve për kuadrin ligjor rregullator, përfshirë, por pa u kufizuar mbi detyrimet lidhur me sigurinë e shëndetin në punë, për mbrojtjen e së drejtës së autorit, për detyrimet fiskale dhe tatimore pas periudhës 24-mujore të inkubimit;
- dhënia e këshillimit për dokumentet e nevojshme për regjistrimin në regjistrin tregtar, nëse e nevojshme, për regjistrimin e patentave, markave tregtare dhe

të shërbimit, disenjove industriale dhe të pronësisë intelektuale, pas periudhës 24-mujore të inkubimit.

- dhënia e këshillimit për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe të të drejtave civile dhe tregtare;
- organizimi i eventeve informuese dhe i aktiviteteve njohëse ndërmjet *startup*-eve të interesuara;
- dhënia e shërbimeve të tjera në drejtim të lehtësimit të aktivitetit tregtar të *startup*-eve.

Neni 13 përcakton se ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes sigurohet për të asistuar e bashkërenduar veprimtarinë e ekosistemit mbështetës për *startup*-et, dhe mbështetjen e *startup*-eve dhe të lehtësuesve të përfshirë në ekosistem, në bashkëpunim me Këshillin e *Startup*-eve.

Neni 14 sjell risi në legjislacion, duke rregulluar mbështetjen e *startup*-eve nëpërmjet granteve dhe masave mbështetëse. *Startup*-et e regjistruara në regjistër përfitojnë mbështetje financiare nga shteti në formën e granteve, si dhe masa të tjera mbështetëse, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje, bazuar në kushtet e përgjithshme, si:

- mbështetja e inovacionit në fusha prioritare për zhvillimin e vendit;
- mbështetja e iniciativave që kanë impakt pozitiv mjedisor;
- fuqizimi i grave sipërmarrëse;
- fuqizimi i përfshirjes sociale, diversiteti dhe impakti social;
- prioritete të tjera sipas urdhrit të ministrit përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes.

Neni 15 normon monitorimin e masave mbështetëse, ku ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, gjatë periudhës së inkubimit dhe periudhës së regjistrimit si *startup* ose si lehtësues i *startup*-eve, monitoron periodikisht *startup*-et dhe lehtësuesit e *startup*-eve, me qëllim verifikimin e përputhshmërisë së zbatimit të këtij ligji. *Startup*-et dhe lehtësuesit kanë detyrimin e raportimit dhe të vënies në dispozicion të dokumenteve të kërkuara nga ministria përgjegjëse për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes brenda një afati të arsyeshëm.

Neni 16 parashikon se Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të ligjit, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 17 rregullon hyrjen në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet e mbrojtjes së sipërmarrjes, si dhe ministritë e linjës ose institucionet e tjera publike brenda kompetencave të tyre.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji u hartua nga një grup pune i përbërë nga këta përfaqësues: ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, me asistencën teknike të GIZ-it, nëpërmjet projektit *EU for Innovation*. Pas procesit të konsultimit publik, komentet dhe sugjerimet nga palët e interesit, të shprehura gjatë konsultimit, janë reflektuar nga kabineti i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes në bashkëpunim me Departamentin Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Kryeministri.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji ka efekte financiare për buxhetin e shtetit, pasi parashikon ngritjen e regjistrit dhe të portalit elektronik për *startup*-et. Sipas një vlerësimi paraprak, është parashikuar që kostoja ekonomike për ngritjen e këtyre dy sistemeve do të mbulohet nga buxheti i shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE